



REPUBLIKA E SHQIPERISE
UJESJELLES KANALIZIME VLORE SH.A
Lagjia “Kushtrimi” Rruga “Arkobaleno” [Tel:033604060](tel:033604060)

Shtojca 13

Autoriteti Kontraktor Sh.a Ujesjelles Kanalizime Vlore
FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data: 29.01.2019]

Për: *Operatorin ekonomik “Ste-La 2000”Sh.p.k* me nr.nipti K12518401O me adrese:
Lagjia Sheq i Madh Rruga Teodor Muzaka, Fier.

* * *

Procedura e prokurimit: ” Blerje kapak pusetash metalik dhe zgarash kuneta shiu” viti 2018

Numri i referencës së procedurës/lotit: **Ref-98607-12-13-2018**

Fondi limit: 5891 700 (pesë milion e tetëqind e nëntëdhjetë e një mijë e shtatë qind)
leke pa TVSH

Burimi i Financimit : Te ardhurat e Sh.A Ujesjelles Kanalizime Vlore

Përshkrim i shkurtër i kontratës: ” Blerje kapak pusetash metalik dhe zgarash kuneta shiu” viti 2018

Kohezgjatja e kontrates: duke filluar nga nënshkrimi i kontrates me përfundim deri në
2(dy) muaj sipas kërkesave të AK

Zhvilluar ne: dt. 03.01.2019 Ora 10:00.Vendi: Vendi: www.app.gov.al.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme d

Njoftojme se,sipas raportit perfundimtar te KVO-se, miratuar nga Titullari I AK, ne tender ka marre pjese 1 operatore ekonomik me oferte perkatese si me poshte:

1.**Ste-La 2000** me nr.nipti K12518401O me oferte ekonomike 5.700.000 leke pa tvsh.

Pas mbarimit të vleresimit të ofertave është arritur në këtë përfundim:

Është kualifikuar Operatori Ekonomik I poshteshënuar:

1. Ste-La 2000 me nr.nipti K12518401O

- Operatori ekonomik nuk ka mundur dot të vertetojë pikën 1 të kapacitetit teknik ku kërkohej : Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohej dëshmi për furnizimet e mëparshme, të njëjtes natyre, të kryera gjatë tri viteve të fundit. Vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë sa 40 % e vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit. Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të leshuara nga një ent publik për realizimin me sukses të kontratës. Kontrata furnizime të ngjashme që ka paraqitur operatori ekonomik është e pavlefshme pasi objekti i kontratës përvoja të ngjashme që ka paraqitur OE është blerje pompa uji, pra nuk janë kontrata të së njëjtes natyre me objektin e prokurimit “blerje kapak metalik të pusëve” dhe si e tillë nuk mund të plotësojë këtë pikë të kapacitetit teknik.

- Operatori ekonomik nuk ka mundur dot të vertetojë pikën 5 të kapacitetit teknik ku kërkohej : duhet të ketë pjesë të stafit të tij një inxhinier ndërtimi dhe një inxhinier mekanik të shoqëruar me kontratë individuale pune, diplome, dhe cv. Operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnjë dokument për të plotësuar këtë pikë të kapacitetit teknik.

1. Duke qënë se ky operator ekonomik nuk i plotëson të gjitha kërkesat për kualifikim Komisioni I Vleresimit të Ofertave ka proceduar me **s’kualifikimin** e operatorit Ekonomik “**Ste-La 2000**”

Në datë 10.01.2019 pranë Autoritetit Kontraktor u paraqit Formulari i Ankesës nr.03 për operatorin ekonomik “Ste-La 2000” shpk Fier, protokolluar pranë Sh.a UK Vlorë me nr.15 prot dt.11.01.2019 i cili kërkon riveçikimin e procedurës dhe kualifikimin e ofertes së tij. Po në datë 11.01.2019 Autoriteti Kontraktor pezulloi procedurë me urdherin e pezullimit nr.31 prot dt.11.01.2019 deri në shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik.

Në datë 18.01.2019 Komisioni i shqyrtimit të ankesave me anë të shkresës nr.52 prot mori vendimin për pranimin e ankesës së operatorit ekonomik Ste-La 2000 shpk, vendim i cili iu komunikua operatorit ekonomik nepermjet shkresës nr.32 prot datë 18.01.2019

Po në datë 18.01.2019 u nxor urdheri i c’pezullimit të procedurës me nr.53 prot ku urdherohet KVO-ja të bëjë riveçikimin e procedurës duke zbatuar vendimin e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave.

Në bazë të vendimit të KSHA-së për kualifikimin e Operatorit Ekonomik Ste-La 2000 Komisioni I Vleresimit të Ofertave ka proceduar me **kualifikimin** e operatorit Ekonomik “**Ste-La 2000**”

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Ste-La 2000”Sh.p.k me nr.nipti K12518401O me adresë: Lagja Sheq i Madh Rruga Teodor Muzaka, Fier, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 5.700.000 (pese milion e shtate qind mije) leke pa tvsh/pikët totale të marra [_____]është identifikuar si oferta e suksesshme.**

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Autoritetit Kontraktor SH.A Ujesjelles

Kanalizime Vlore Lagjia “Kushtrimi” Rr.Arkobaleno sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pese) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimit, te gjithë dokumentacionin e paraqitur ne tender (original ose fotokopje e noterizuar), I cili verifikohet nga KVO dhe behet pjese e dosjes se tenderit.

Dokumentacioni i listuar me shkrim dhe numer faqesh, duhet te jete i futur ne nje zarf te mbyllur dhe i vulosur me vulen e operatorit/subjektit. Zarf i dokumentacionit te tenderit duhet te paraqitet brenda afatit te mesiperm, ne sekretarine e SH.A UK Vlore per tu protokolluar.

Nëse dokumentacioni i tenderit, pas verifikimit rezulton i rregullt, atëherë do te procedohet menjëherë me nënshkrimin e kontratës, nga përfaqësuesit e te dy palëve.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 08.01.2019

Ankesa: ka ose jo Jo

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

* * *



Dorian Xhelili

Titullar i Autoritetit

Kontraktor